 Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12	Kodi DA-IN-009
		Rishikim nr 3 Dt. 12.02.2024
		Faqe 1-5


Udhëzues për zbatimin e dokumentit IAF MD 15 dhe IAF MD 12

Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese

Kontrolloi: Menaxheri i cilësisë
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm
Pranvera FAGU

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p align="center">Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12</p>	<p align="right">Kodi DA-IN-009</p>
		<p align="right">Rishikim nr 3 Dt. 12.02.2024</p>
		<p align="right">Faqe 2-5</p>

1. QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit që janë të akredituar nga DPA.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të akredituar, vlerësuesit dhe stafi i DPA. Ky dokument i referohet standardin ISO/IEC 17021-1 por nuk bie në kundërshtim dhe nuk shfuqizon asnjë kërkesë të ISO/IEC 17021-1.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit dhe si e tillë rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshime të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA është nën përgjegjësinë e menaxherit të cilësisë. Është detyrë e Drejtorit të drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA


SSH ISO/IEC 17021-1:2015,
S SH ISO/IEC 17011 :2017
IAF MD 5:2023
IAF MD 2:2023
IAF MD 15:2023
IAF MD 12 :2023
DA-PO-002
DA-PT-003

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit ISO/IEC 17011:2017

IAF Forum Nderkombëtar i Akreditimit
EA Organizata Evropiane e Akreditimit
DPA Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit

Vendndodhja fikse zyre nënkupton: ambientet e përhershme ku kryhen dhe/ose menaxhohen për OVK-në aktivitetet e certifikimit, pavarësisht vendndodhjes dhe marrëdhënies me OVK-në.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12</p>	<p>Kodi DA-IN-009</p> <hr/> <p>Rishikim nr 3 Dt. 12.02.2024</p> <hr/> <p>Faqe 3-5</p>
---	---	--

Aktivitete të tjera nënkupton funksione të certifikimit të cilat nuk janë aktivitete kyçe

Personel në distancë nënkupton individët të cilët mund të jenë të staf i përhershëm ose të jashtëm që kryejnë veprimtari certifikimi për një OVK dhe nuk punon në një vendndodhje fikse zyre.

6. PËRMBAJTJA

1. Të përgjithshme


Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si anëtare firmosëse e IAF MLA dhe EA MLA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit ka detyrimin të zbatojë të gjithë dokumentat e detyrueshme të lëshuara nga EA dhe IAF. Si rrjedhim të gjithë organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të akredituara nga DPA janë të detyruar të zbatojnë gjithashtu kërkesat e dhëna në dokumentat e lëshuara nga EA dhe IAF përveç atyre të vendosura në standardet e akreditimit. Dokumentat e lëshuara nga EA dhe IAF janë kritere për akreditim dhe sit ë tilla janë të përfshira në politikën e DPA, DA-PO-002. Dokumenti IAF MD 15 identifikon të dhënat e performancës së organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit të cilat duhet të mblidhen nga organizmat akreditues.

Nga Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF), kërkohet që të gjithë organizmat akreditues anëtar të IAF të përgatisin një udhëzues për mënyrën e mbledhjes së të dhënave nga organet certifikues të sistemeve të menaxhimit.

Bazuar në pikat 7.4.6; 7.4.7 dhe 7.9.2 të standardit ISO/IEC 17011 organizmi akreditues duhet të marrë në konsideratë aktivitetet, vendndodhjet dhe personelin në hartimin e planeve të vlerësimit për çdo vlerësim dhe mbikëqyrje dhe programit të vlerësimit për ciklin e akreditimit.

Bazuar në dokumentin IAF MD 12, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit duhet të dërgojnë informacion tek organizmat akreditues në lidhje me shtetet ku janë lëshuara certifikata, shtetet ku organi certifikues ka zyrë apo vendndodhje fikse zyre , apo shtetet ku organi certifikues ka personel në distancë.

Mbledhja e të dhënave mbi performancën e organeve certifikues të sistemeve të menaxhimit dhe në lidhje me shtetet ku kryhet apo menaxhohet veprimtaria e certifikimit do të bëhet në bazë vjetore (brenda muajit Janar të çdo viti kalendarik). Raportimi do të bëhet sipas formës DA-FO-091.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12</p>	<p>Kodi DA-IN-009</p> <hr/> <p>Rishikim nr 3 Dt. 12.02.2024</p> <hr/> <p>Faqe 4-5</p>
---	---	--

Informacioni që do të jepet nga organet certifikues të sistemeve të menaxhimit do të përpunohet nga stafi i DPA dhe do të shërbejë për një planifikim më të mirë të vizitave mbikëqyrëse dhe prgramit të vlerësimit.

2. Indikatorët e performancës

Për të realizuar një raportim sa më të saktë dhe të përdorshëm, kërkohet që raportimi të bazohet në indikatorët e mëposhtëm:

1. **Numri i certifikatave të akredituara të lëshuara deri në fund të Dhjetorit.** Numri i certifikatave të vlefshme do të raportohet si më poshtë:


- Nëse një klient mban një certifikatë të vlefshme e cila mbulon vetëm një vendndodhje, kjo do të numërohet si një certifikatë.
- Nëse një klient mban një certifikatë- e cila mbulon më shumë se një vendndodhje, kjo do të numërohet si një certifikatë, Vendndodhjet e numërohen secila më vete.
- Kur një klient mban disa certifikata (për cdo vendndodhje) ose një certifikatë për disa vendndodhje, organi certifikues do të raportojë numrin total të certifikatave.
- Kur një klient është certifikuar kundrejt më shumë se një standardi të sistemit të menaxhimit dhe organicertifikues ka lëshuar vetëm një certifikatë që mbulon të gjitha standardet, atëherë organi certifikues do të raportojë aq certifikata sa sisteme menaxhimi janë certifikuar.

Shënim: Certifikata të vlefshme nënkupton ato certifikime që kanë statusin aktiv ose të pezulluar. Certifikatat e tërhequra nuk duhet të numërohen dhe të raportohen.

2. **Numri i auditorëve të përdorur për cdo skemë certifikimi.**
3. **Numri i certifikatave (apo certifikimeve) të transferuara të pranuar nga organi certifikues.** (Lutem referohuni dokumentit IAF MD 2).
4. **Numri i auditimeve të kryera me vonesë**
5. **Numri i ditëve të auditimeve të kryera (në kohë normale dhe me vonesë)** (Lutem referohuni dokumentit IAF MD 5).

3. Mbledhja e të dhënave

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimi i kërkon të gjithë organeve certifikues të sistemeve të menaxhimit të akredituar prej saj të japin informacion në lidhje me:

 <p> Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al </p>	<p align="center"> Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12 </p>	Kodi DA-IN-009
		Rishikim nr 3 Dt. 12.02.2024
		Faqe 5-5

- i) Shtetet në të cilat organi certifikues ka lëshuar certifikata të akredituara dhe, numrin e certifikatave të akredituara të lëshuara në secilin shtet;
- ii) Shtetet në të cilat organi certifikues ka vendndodhje fikse zyre që kryen aktivitete të certifikimit;
- iii) Shtetet në të cilat organi certifikues ka personel në distancë të vendosur atje që kryen cdo aktivitet certifikimi.
- iv) Cilat nga vendndodhjet fikse zyre kryejnë ose menaxhojnë aktivitete kyce sic përcaktohet në IAF/ILAC A5 ose nga ku personeli në distancë kryen ose menaxhon aktivitete kyce; dhe
- v) Masat e marra nga organi certifikues për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të kryera nga vendndodhjet fikse zyre të vendosura në vendet e huaja ose nga personeli në distancë

Informacioni i marrë do të përdoret nga DPA për hartimin e programit të vlerësimit për gjithë ciklin e akreditimit dhe në rastet e mbikëqyrjeve dhe riakreditimit si dhe planit të mbikëqyrjeve.

Në rastin e zgjerimit të fushës së akreditimit, OVK duhet të japë informacionin e kërkuar në pikën 3 të këtij udhëzuesi që në fazën e aplikimit për zgjerim.

DPA zbaton politikën e saj DA-PO-002, procedurën DA-PT-003 dhe dokumentin IAF MD 12 për hartimin e programit të vlerësimit.